



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 28.09.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të komisionit.
2. Diskutimit dhe miratimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Sokol Sadushi – Ekspert i Nivelit të Lartë

Rainer Deville – Ekspert i Nivelit të Lartë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi aty ku është ndërprerë mbledhjen e kaluar, te shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.200 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Herën e kaluar u bë një prezantim i amendamenteve që janë kërkuar ose reflektimeve të nevojshme që mund të bëhen në projekt. Tani është momenti, pasi dhe relatorit i janë vënë në dispozicion projektet dhe pretendimet, se çfarë është parashtruar për t’u reflektuar, edhe ekspertët kanë pasur kohën për të reflektuar më mirë.

Fillojmë shqyrtimin nen për nen. Po bëjmë një shqyrtim të shpejtë nen për nen, sepse e kemi kaluar një herë, por për saktësi dhe për të pasur qëndrueshmëri të tekstit, po e bëjmë përsëri. Aty ku ka vend për ndërhyrje, thoni se ka vend për ndërhyrje. Dakord?

Neni 1. Nuk ka gjë. Do të mbetet siç është.

Neni 2. Dakord.

Neni 3. Dakord.

Neni 4. Dakord.

Neni 5.

**Pandeli Majko** – E keni edhe tek tabela që ka secili koleg përpara, është bërë një ndryshim te neni 7, germa “a”, ku pika 2, po e citoj siç duhet të jetë: “Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet të plotësojë edhe këto kritere: të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor, ose lektor i nivelit të së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese dhe i Gjykatës së Lartë.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Kam diçka për të sugjeruar. Ne kemi bërë një koment që termi “ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese dhe i Gjykatës së Lartë” duhet të kalojë në pikën 3, germa “b”.

Për sa i përket sugjerimit që bën zoti Majko...

**Fatmir Xhafaj** - Pse duhet të bëjmë një përjashtim për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë”? Në çfarë kuptimi?

**Sokol Sadushi** - Në projekt ka qenë e vendosur jo në mënyrë korrekte, sepse nuk ka gjetur reflektim nga Kushtetuta. Në Kushtetutë është korrekte deri te fjalët “në administratën publike”.

**Fatmir Xhafaj** - Ata nuk janë nëpunës të nivelit të lartë të administratës publike?

**Sokol Sadushi** - Jo sipas ligjit “Për shërbimin civil”, i cili ka në kategori të veçantë personat që janë nëpunës të nivelit të lartë. Pra, nuk përfshihen aty. Ne sugjerojmë që qenia këshilltar në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë është një tendencë që përgjithësisht është në të gjitha vendet, është një mundësi e mirë për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Nuk e ka vendin këtu, por e ka te pika 3, germa “b”. Krahas kriterëve të tjera shërben si një kriter që vlerësohet krahas vjetërsisë në profesion, përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës.

**Fatmir Xhafaj** - Kjo pjesë do të kalojë...

**Sokol Sadushi** - Kemi vetëm një zhvendosje për të qenë korrekt me normën kushtetuese. Ky është sugjerimi.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Po 7, germa “b”, çfarë ka?

**Pandeli Majko** – Të vendoset shprehja “institucione publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë” dhe të shmanget rreshtimi i të gjithë atyre me radhë. Pak a shumë kjo është duke u konsultuar edhe me vërejtjet e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, që është shprehur me shkrim për këtë pikë.

**Sokol Sadushi** - Këtu në krah është komenti që kemi bërë ne mbi bazën e sugjerimit që bën kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Sugjerimi i tij në opinionin tonë mund të pranohet, por jo në tërësi.

**Pandeli Makjo** - Sigurisht, ne e pranojmë atë që e konsiderojmë të vlefshme.

**Sokol Sadushi** - Zoti Majko po flas për opinionin tim.

**Pandeli Majko** – Më falni, se fola dhe në emrin tuaj. Kemi pasur një diskutim goxha të gjatë me ekspertët në këtë pikë.

**Sokol Sadushi** - Unë po sugjeroj. Në ligj është vendosur Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe rektoratet e universiteteve, sugjerimi që bën kryetari i Gjykatës Kushtetuese është që nuk ka pse të jetë marrja e opinioneve nga organizmat e tjerë, sepse mund të krijojë problematikë për sa i përket lobimit apo politizimit e të tjera. Ne kemi sugjeruar që të jetë e mundshme të vendoset një dispozitë e tillë, sepse marrja e opinioneve i vlen, por nuk janë detyruese. Sugjerojmë të ndryshohet formulimi, të mos jetë shterues

vetëm Dhoma Kombëtare dhe rektoratet, sepse duket sikur është kufizuese. Sugjerimi është: “Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë”. Mund të dëshirojnë të thonë. Pastaj e vlerëson Këshilli i Emërimeve, e vlerëson Presidenti nëse opinioni i tyre duhet marrë në konsideratë.

**Fatmir Xhafaj** - Ka ndryshim tjetër?

**Sokol Sadushi** – Ka dhe një ndryshim tjetër. Është një sugjerim me vend që bën kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

**Pandeli Majko** - Bën dallimin e dy listave, të listave të kandidatëve, njëra prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit. Një dallim esencial, i cili do të ndihmojë në trajtimin e kandidaturave që do të trajtohen nga Gjykata Kushtetuese, ku do të dallohen ata që vijnë nga radhët e gjyqësorit dhe ata që vijnë nga radhët e jogjyqësorit.

**Fatmir Xhafaj** - Mund të qëllojë të jetë njëkohësisht kandidati që zgjedh Presidenti kandidat që zgjedh Kuvendi. Pse duhet një nga gjyqësori?

**Sokol Sadushi** – Më lejoni ta shpjegoj se çfarë qëllimi ka kjo dispozitë. Këtu bëhet fjalë për një kandidaturë nga Presidenti, sepse kandidatura nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë është në nenet pasuese, por mund të ndodhë në një rast eventual, që mund të jenë katër kandidatura, katër vende bosh. Jemi duke folur për një moment që nëse janë dy vende bosh, atëherë njëherë e merr Presidenti, Kuvendi dhe të tretin e merr Gjykata e Lartë. Ky është rast kur janë katër vende bosh. Arsyet pse janë katër vende bosh mund të jenë të ndryshme, si dorëheqja e të tjera. Nëse do të kemi katër vende bosh, atëherë do të ndodhë që në katër vende bosh një e ka Presidenti, një e ka Gjykata e Lartë dhe një e ka Kuvendi, vendi i katër si radhë i përket Presidentit. Mund të jenë pesë vende bosh, vendi i pestë i përket Kuvendit, mund të jenë gjashtë vende bosh, vendi i gjashtë i përket Gjykatës së Lartë. Në rastin kur kemi katër vende bosh apo kur kemi pesë vende bosh, që është dispozita më pas, duhet që në listë të mos jenë vetëm jogjyqtarë, por të ketë një listë nga jogjyqtarët. Ne sugjerojmë mbi bazën edhe të sugjerimit që bën kryetari i Gjykatës Kushtetuese, që na duket korrekt, të jetë një listë tjetër me gjyqtarë. Në vlerësimin e Presidentit, të Kuvendit nuk ka pengesë Kuvendi të zgjedhë edhe një që është nga trupa gjyqësore. Qëllimi është që trupa e Gjykatës Kushtetuese minimumi ka tre gjyqtarë që i zgjedh Gjykata e Lartë. Do të ishte mirë që kjo trupë, në përbërje të saj të kishte sa më shumë gjyqtarë, maksimumi që mund të ketë gjyqtarë shkon deri në pesë, nuk shkon më tepër sesa pesë. Katër të tjerët janë jogjyqtarë, ashtu si mund të jenë edhe gjashtë jogjyqtarë dhe vetëm tre të jenë gjyqtarë. Këtë sugjerim të kryetarit ne e kemi kthyer në dispozitë dhe e quajmë korrekte.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 7, germa “c”.

**Pandeli Majko** – Është vazhdim i rregullimit të kësaj që sapo diskutuam.

**Fatmir Xhafaj** – Është e njëjta. Replikohen ndryshimet te germa “b”, edhe te germa “c”.

**Pandeli Majko** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

7, germa “ç”. Besoj se është e njëjta gjë.

**Pandeli Majko** – Te pika 2, fjalia e fundit të shikohet në vazhdim të kësaj që sapo diskutuam: “Dhe të institucioneve publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë”. Pra, është rregullimi i frymës së atyre që kemi ndryshuar në nenet e mësipërme.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

7, germa “d”.

**Pandeli Majko** – Ka rregullime të vogla, sa nuk ia vlen ta citosh nga fillimi deri në fund.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 6.

**Pandeli Majko** – Nuk kemi ndonjë gjë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Neni 7.

**Pandeli Majko** – Te neni 7 ka një sugjerim të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese që të mos shprehet Gjykata Kushtetuese për përfundimin e mandatit normal sipas germës “b” të nenit, por ne mendojmë se duhet të shprehet Gjykata Kushtetuese, duhet të ketë një akt formal të prodhuar nga Gjykata Kushtetuese për këtë çështje. X-it, Y-it, i mbaroi mandati.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Mbetet siç është.

Nenin 8.

**Pandeli Majko** – Nuk kemi gjë.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 9 që ndryshon nenin 10.

**Pandeli Majko** – Sokol, do të ishte më bindëse nga ana juaj nëse do të flisje për nenin 10, për shkeljet disiplinore.

**Sokol Sadushi** - Ka një sugjerim nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese lidhur me nenin 10, për pikat 3, 4 dhe 7. Ai sugjeron të mos zërë vend në ligj rasti i mosnjoftimit të kryetarit kur ka ndërhyrje te gjyqtari, edhe rasti kur gjyqtari duhet të paraqesë kërkesën për

heqje dorë dhe ai nuk e paraqet, kur është i dukshëm. Sugjerimi është që të hiqet. Në fakt, në opinionin tonë është që të qëndrojë siç është dispozita, sepse ne kemi ruajtur të njëjtin standard si për të gjithë gjyqtarët e tjerë. Është shumë e rëndësishme edhe për shkak të orientimeve që ka reforma në drejtësi që pikërisht këto çështje nuk duhet të lëvizin. Nëse ka një ndërhyrje te gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, ai ka detyrimin për ta bërë me dije këtë gjë. Në qoftë se ka kushtet për të hequr dorë, gjyqtari i Kushtetueses duhet të japë dorëheqjen. Kështu që nuk mund të bëjmë ndonjë dallim midis gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe atij të zakonshëm, sepse është një standard që ka gjetur tashmë vend edhe në Kushtetutë dhe në ligje të tjera. Prandaj mendojmë që dispozita të mbetet siç është.

**Pandeli Majko** – Jemi te detajet që zoti Rainer i ka shumë qejf.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 10.

**Rainer Deville** – *(flet përkthyesja)* Mund të konfirmoj se kemi diskutuar gjithçka së bashku me zotin Sadushi, kështu që ky është edhe mendimi im.

**Fatmir Xhafaj** – Me sa kuptoj, edhe për ekonomi kohë ka lënë të flasë zotin Sadushi për ta fiksuar procesverbalin në shqip. Megjithatë, nëse zoti Deville e sheh të arsyeshme, mund të ndërhyjë në vazhdim.

Neni 10/a. Dakord.

Neni 10/b “Masat disiplinore”.

**Pandeli Majko** – Ne mendojmë të mbetet kështu siç është, pavarësisht se ka një rezervë nga ana e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e vërejtjes publike.

**Fatmir Xhafaj** – Të them të drejtën, edhe unë jam me dakord me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Unë nuk e di arsyen pse. Çfarë kuptoni ju me “vërejtje publike për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese”? Ai ka një vërejtje me shkrim, është ulja e përkohshme. Ndoshta, ka të bëjë me autoritetin e trupës.

**Pandeli Majko** – I rritet autoriteti trupës kur bën një transparencë të një natyre të tillë dhe në thelb shton përgjegjshmërinë.

**Sokol Sadushi** – Për më tepër që është gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Jam i bindur se për vetë pozicionin që ka nuk do të ketë vërejtje publike, sepse është një pozicion shumë i lartë, por nuk mund të përjashtohet gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë apo të gjykatave të zakonshme nga kjo lloj mase disiplinore. Ne kemi mbajtur të njëjtin standard si në ligjin për statusin e gjyqtarit edhe në këtë rast.

**Fatmir Xhafaj** – Ai nuk është pjesë e sistemit gjyqësor dhe nuk mund ta barazoni çdo gjë që ka gjyqtari i zakonshëm me atë të Gjykatës Kushtetuese, pra statusi i gjyqtarëve të

tjerë nuk i vlefshëm me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Nuk është argument në pikëpamjen që keni barazuar statusin, sepse ai nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor. Në qoftë se këtu është e nevojshme, po, por nëse bëhet për efekt barazie, nuk është argument.

**Sokol Sadushi** – Kjo ishte e dyta.

E para ishte që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, në qoftë se ka ardhur momenti që duhet të marrë një vërejtje, është një veprim i rëndë për të. Kështu që unë nuk e mendoj se gjyqtari i Kushtetueses do të marrë një vërejtje, se edhe vërejtja me shkrim e rëndë është. Vërejtja me shkrim nga vërejtja publike e rëndë është. Në qoftë se gjyqtari i Kushtetueses merr vërejtje me shkrim, e rëndë është, por unë nuk dua ta besoj se e merr një vërejtje të tillë. Në qoftë se vjen momenti që do të marrë një vërejtje publike, ndoshta do të jetë më korrekt dhe është më mirë të jetë se të mos jetë. Në këtë kuptim, gjykoj se ky është një standard që nuk ka pse të shqetësohet gjyqtari Kushtetues nga vërejtja publike, se në fund të fundit, ata vetë do t'ia japin vërejtjen kolegut të tyre. Në qoftë se kolegu i tyre është bërë për të marrë një vërejtje publike, është një situatë ekstreme dhe le ta dijë më mirë publiku. Prandaj unë nuk e quaj shqetësim këtë gjë. Duket sikur ka një ulje të nivelit të gjyqtarit Kushtetues, por janë të gjitha dispozitat që edhe shkarkimi i gjyqtarëve, të gjitha masat disiplinore që merren ndaj tyre, janë në funksion të një standardi të lartë që duhet të ruajmë për gjyqtarin dhe nuk duhet të bëjmë diferencë. Ky është qëndrimi ynë. Megjithatë, vlerësojeni ju nëse vërejtja publike është një vërejtje që nuk duhet të qëndrojë.

**Pandeli Majko** – Po sjell një rast: anëtari i Gjykatës Kushtetuese për arsye të ndryshme jep një intervistë publike dhe shpreh rezerva ose sulmon jo vetëm profesionalisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese, atëherë përderisa ai ka përdorur një mekanizëm të një natyre të tillë karshi institucionit ku bën pjesë, edhe institucioni do t'i drejtohet atij me të njëjtën monedhë. Jo se aty mund të jetë krijuar ndonjë shumicë e kalbur, por, në qoftë se gjërat do të bëhen nën këtë mekanizëm, do të përdoret ky mekanizëm. Gjithashtu, mendoj që shpesh për arsye nga më të çuditshme do të jenë shumë të rralla, sepse po flasim për raste 1 në 1 milion, por duhet t'i mendojmë edhe këto raste të rralla, kur veprimet e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese mund të jenë të një natyre të tillë nëpërmjet kryerjes së vërejtjes publike krijon edhe një distancë midis moralit dhe vlerave të institucionit që quhet Gjykatë Kushtetuese dhe individit që e ka kryer atë.

**Fatmir Xhafaj** – S' do ta mbështes arsyetimin tënd.

**Pandeli Majko** – Kjo ndodh gjithmonë kur mungon opozita këtu.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është çështje pozicioni. Më duket gjë e tepërt dhe përgjithësisht nuk bie dakord me principin që kufizimet apo rregullat, të cilat janë në statusin e gjyqtarit, duhet të reflektohen patjetër të gjyqtari i Kushtetueses. Vërtet të dyja palët janë gjyqtarë, por ky është gjyqtar më një status të veçantë.

**Pandeli Majko** – Kurse unë mendoj se, në qoftë se ka titullin gjyqtar, nga dita e parë që është gjyqtar deri ditën e fundit duhet të trajtohet me të njëjtin standarde si kolegët e tjerë për sa u përket masave disiplinore.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk janë njësoj. Është mirë të mos e hapim këtë diskutim. Nuk ka si të jetë njësoj gjyqtari i Shkallës së Parë me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor.

**Pandeli Majo** – Në qoftë se do të biem dakord që niveli në strukturën gjyqësore do të përcaktojë masa të ndryshme disiplinore, kjo është një histori tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Patjetër.

**Pandeli Majko** – Unë një pjesë të diskutimit që po bëj e kam edhe nga diskutimi me Sokolin, sepse edhe unë kam pasur një lloj rezerve në këtë drejtim, është se masat disiplinore janë standarde, pavarësisht në çfarë zyrë qëndron. Presidenti i Republikës apo Kryeministri mund të dënohen me burg, në qoftë se kryejnë një vepër penale, si çdo qytetar tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka të njëjtin status si të gjithë qytetarët.

**Pandeli Majko** – Mirë, në rregull, por për veprën penale do të dënohen njëlloj.

**Fatmir Xhafaj** – Nejse, të mos i hyjmë as çështjeje, se nuk është e njëjta gjë. Unë kam rezerva për këtë.

Neni 10/c. Dakord.

Neni 10/ç. Dakord.

Neni 11. Dakord.

Neni 12. Dakord.

Neni 13. Dakord.

Pse e keni bërë te neni 14 “Administrata e Gjykatës Kushtetuese dhe tabela”?

*(Reagim pa mikrofon.)*

Te ligji ekzistues. Mua më duket që ka të drejtë. Pse të mos e shënojmë që administrata e gjykatës përbëhet nga nëpunësit civilë, kabineti i kryetarit, sepse ai është një etnitet më vete dhe punonjës të tjerë?



**Sokol Sadushi** – Në opinionin tonë, shqetësimi që ka kryetari i Gjykatës Kushtetuese...

**Fatmir Xhafaj** – Në qoftë se përfshihet tek “nëpunës të tjerë”, dakord. I jep një status të veçantë, sepse është kabineti i tij i punës. Unë them ta përfshijmë.

**Sokol Sadushi** – Nuk kemi ndonjë kundërshti të madhe në këtë pikë, thjesht donim të bënim një sqarim.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Neni 14/a “Njësia e shërbimit ligjor” këtu është? Kemi bërë një gabim, sepse para kësaj duhej të shqyrtonim nenin 14, që mbetet siç është.

Neni 15 është “Administrimi i Gjykatës Kushtetuese”...

**Sokol Sadushi** – Zoti kryetar, e ndryshuat nenin 14 sipas ndërhyrjes që bëtë për kabinetin. Pra, nuk mbetet siç është, por ndryshon.

**Pandeli Majko** – Patëm një problem në numërtim.. Nuk ka problem.

**Fatmir Xhafaj** – Te neni 15 i projektligjit, që ndryshon nenin 14 bëmë ndryshimin që administrata e Gjykatës përbëhet nga nëpunësit civilë etj. Tani këtu keni propozuar nenin 14/a?

**Pandeli Majko** – “Njësia e shërbimit ligjor”. Është një ndryshim te pika 3, të cilën po e citoj: “Jo më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve. Këshilltari ligjor, që vjen nga radhët e juristëve, përfiton një pagë të barabartë me pagën e gjyqtarit të Shkallës së Parë, pa shtesat e vjetërsisë”.

**Fatmir Xhafaj** – Në parim dakord jam, por vetëm të shikojmë nëse paga e gjyqtarit të Shkallës së Parë është shumë afër pagës së një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese. Në tabelën e parë që do të miratojë sot Këshilli i Ministrave mund të vendosim një përqindje në raport me pagën”.

**Pandeli Majko** – Nuk mendoj se Këshilli i Ministrave do ta bëjë kaq të afërt pagën e gjyqtarit...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk e di. Të shikojmë tabelën e pagave që do të vijë dhe pastaj ta rregullojmë këtë.

**Pandeli Majko** – I bie që kapiteni apo nënkoloneli ta ketë gati baras pagën me gjeneralët!

**Fatmir Xhafaj** – Të ecim dhe të mos bëjmë paralelizma. Biem dakord në parim? Dakord.

Neni 17.

**Rainer Deville** – *(flet për kthyesja)* Këshilluesit ligjorë aktualë dhe ata që do të shërbejnë në të ardhmen duhet të kombinojnë dy parime konfliktuale.

Nga njëra anë, Gjykata Kushtetuese dëshiron që asgjë të mos ndryshojë dhe të ketë vazhdimësi në shërbim, nga ana tjetër, qëllimi i reformës është që t'i japë fund korrupsionit, t'i thyejë këto rrjete që janë krijuar dhe të krijojë sistemin e rotacionit. Kështu, ne sugjerojmë që këshilltarët ligjorë të qëndrojnë në detyrë për mandatin 5-vjeçar, me të drejtën e riemërimit vetëm një herë dhe e gjithë periudha e qëndrimit në detyrë do të jetë 10 vjet dhe më pas do të ketë rotacion.

**Fatmir Xhafaj** – Është ky formulimi që kemi ne këtu?

**Sokol Sadushi** – Në fakt, është një sugjerim që ne e kemi diskutuar.

Bëhet fjalë që pikën 3, të bëhet një ndryshim, një shtesë. Në pikën 3: “Njësia e shërbimit ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, të cilët emërohen nga kryetari”, dhe shtohet togfjalëshi “për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë riemërimi”.

**Fatmir Xhafaj** – Pse “për një periudhë 5-vjeçare”? Unë e kuptoj për gjyqtarët që janë magjistratë, por ata të tjerët nuk krijojnë stabilitet, se ne kemi nevojë që të kemi një bërthamë aty te njësia që të krijojë stabilitet, të paktën këta që janë jogjyqtarë duhet të krijojnë një lloj stabiliteti. Ne e lëmë sekretarin e Përgjithshëm, kancelarin dhe u japim statusin e nëpunës të shërbimit civil për të siguruar qëndrueshmëri, por një bërthamë brenda kësaj njësie duhet të jetë, që t'i japë qëndrueshmëri praktikës, memories e të tjera, sepse në qoftë se ne i ndërrojmë çdo 5 vjet, pra vjen kryetari dhe i ndërrohet së pari, nuk krijojmë stabilitet dhe memorie shkencore. Të paktën një pjesë e tyre duhet të jenë, domethënë nuk bie shumë dakord me këtë gjë.

**Pandeli Majko** – Edhe unë kam këtë rezervë, sepse mbase na ngatërron pak edhe titulli i kësaj historie që quhet “këshilltar” dhe e barazojmë këshilltarin e Gjykatës Kushtetuese apo këshilltarin ligjor, këshilltarin e ministrit për shembull, që e trajtojmë si një fenomen politik dhe që e kemi përjashtuar në ligj. Përshtypja ime dhe jo vetëm, është se këshilltari ligjor i një ministri apo kryeministri, vërtet janë poste politike, por nuk ka të bëjnë fare, ka vetëm emrin e përbashkët këshilltar në rastin e këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese apo të Gjykatës së Lartë. Nga një pikëpamje e caktuar, nëse do më pyesnit mua, personalisht, por unë nuk mund të konsiderohem i besueshëm për këtë pikë, për mua ka shumë rëndësi cilësia e këshilltarit të gjykatës, ajo duhte të jetë pak më e mirë sesa kontrapati me të cilën ai barazohet në pagë, që është ashtu siç e thashë këtu, gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë, sepse në thelb ky jurist, pra po e fillojmë nga koncepti i juridikbërjes, duhet të jetë shumë më

cilësor. Është njeriu që do të shkruaj letrat e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është njeriu që do të ndihmojë, në çdo rast, me memorien e tij, të gjithë kategorinë e anëtarëve të Gjykatës së Lartë apo Gjykatës Kushtetuese që do të vijnë në vendin e punës. Në këtë pikë bashkohem me zotin Xhafaj, që thotë se ne sekretarit të Përgjithshëm i japim mandat derisa del në pension, sepse ka statusin e administratës civile, te këshilltari ngatërrohem dhe e konsiderojnë si një dëshirë personale, subjektive të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese apo të kryetarit të Gjykatës së Lartë. Nëse është kështu, atëherë ejani ta diskutojmë se mos ndoshta duhet t'i japim statusin e administratës civile.

Nuk mendoj se çështja e korrupsionit në Shqipëri ka ardhur nga këshilltarët ligjor. Çështja e korrupsionit në Shqipëri ka rrjedhur nga vullneti i atyre që kanë pasur mandat, gjykatësit. Gjykatësi e ka thirrur këshilltarin dhe ka thënë e dua kështu vendimin, në qoftë se bëhet fjalë për të rrëshqitur diçka, por jo këshilltari ligjor t'i thotë anëtarit të gjykatës që duhet të bëhet kështu apo duhet të bëhet kështu, shef, sepse t'i mund të fitosh ca lekë më tepër me ndërtimin e fjalisë në këtë mënyrë siç po ta shkruaj.

**Fatmir Xhafaj** – Dua të shtoj edhe një argument këtu. Mua më është dukur ide shumë racionale ajo që keni propozuar ju, me sa di është propozimi juaj personal, ndoshta nisur edhe nga përvoja e vendeve tuaja. Ata nuk janë këshilltarë të një gjyqtari të veçantë, janë pjesë e njësisë. Në rregull, unë jam shumë dakord me logjikën që thatë ju. Për sa kohë që ata që ishin këshilltarë të një gjyqtari, në momentin që ishin këshilltarë të një gjyqtari, kjo mund të kishte një rrezik, potencialisht, por zgjidhja që keni dhënë ju është një zgjidhje e shkëlqyer, nuk hezitoj ta them.

E para, nuk ka më këshilltarë pranë një gjyqtari të posaçëm dhe vetë këshilltarët janë me short për çështjet, që mund të mos përputhet çështja që ka këshilltari me një gjyqtar respektiv, të dyja palët janë çështje me short. Kështu që e gjithë kjo e zgjidh atë shqetësimin. Zgjidhja e madhe që keni dhënë ju, që ndahet, që nuk ka këshilltar pranë një gjyqtari dhe gjithë çështjet bëhen me short respektivisht, është një zgjidhje shumë e mirë dhe ne e kemi vlerësuar. Ky është një detaj që nuk do ta bënte më të fortë, përkundrazi, rrezikon që ta dobësojë këtë ide racionale, mund ta dobësojë në praktikë. Kështu që besoj se do të bëjmë një kompromis këtu: ju keni idenë e madhe, ne kemi detajin e vogël, por që insistojmë.

Së dyti, ju keni shënuar te pika 3 “Jo më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratit”. Jo, e keni gabim është “Jo më pak se gjysma” është në favor të magjistratëve.

Urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Jo kemi merakun që në qoftë se nuk arrihen të bëhen, sepse një frikë mund të ekzistojë, që mund të mos kenë dëshirë.

**Fatmir Xhafaj** – Ju deri dje propozonit që ishin të gjithë nga magjistratura, sot kemi vënë “Jo më pak se gjysma”. Ideja është për t’i dhënë më shumë peshë njerëzve që vijnë nga magjistratura, është e drejtë dhe ne do ta mbështesim këtë ide, por qëndrimi që do të mbajmë është “Jo më pak se gjysma”. Për këtë gjë kemi rënë dakord.

**Sokol Sadushi** – Këtë vlerësojeni ju, por shqetësimi ynë ka qenë, nëse mund të krijohet një situatë kolapsi, që nuk arrin dot magjistratë të dëshirojnë të vijnë...

**Fatmir Xhafaj** – Vendosim atë që tha zoti Rainer, vendosim dispozitë transitorë në harkun e 2 vjetëve, sa të kemi prurjet e reja të Shkollës së Magjistraturës. Shiko, ne nuk jemi këtu që t’i gjejmë vend pune atyre që janë aty, dhe për më tepër nuk është e thënë që të gjithë ata që janë aty, janë të aftë dhe këtë bindje e kam. Kam shumë respekt për punën e këshilltarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe shumë respekt për punën e këshilltarëve në Gjykatë të Lartë, por nuk mendoj se të gjithë këshilltarët kanë cilësi të tilla, që detyrimisht duhet të rrinë këtu. Ata që nuk i plotësojnë kriteret, cilësitë, standardet të hapin rrugën. Ne po bëjnë gjithë këtë reformë për gjyqtarët dhe prokurorët, jo më për këshilltarët, por “jo më pak se gjysma” është një gjë e arsyeshme, të paktën gjysma.

E dyta, “Numri i këshilltarëve ligjorë caktohet me vendim të mbledhjes së gjyqtarëve, por brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të Gjykatës Kushtetuese”.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Jo, ju thoni: “Numri i këshilltarëve caktohet me vendim të mbledhjes së gjyqtarëve”, por mundet që gjyqtarët të mblidhen dhe të thonë na duhen 40 këshilltarë këtu, por brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve Gjykatës Kushtetuese. Të kufizohet, unë besoj fort se nuk e bën mbledhja e gjyqtarëve, por “brenda numrit të përgjithshëm”.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Po, pra brenda strukturës.

Në rregull, me këto ndryshime? Keni sugjerim?

Në rregull.

Faleminderit, zoti Devill!

Faleminderit, zoti Sadushi, për mirëkuptimin, edhe zonja Vorpsi është e mirëkuptuar, dhe kjo është një gjë shumë pozitive!

Neni 16 dakord, me këto ndryshime, përfshirë edhe momentin e pagës që e thamë.

Neni 17. Në rregull, nuk kemi gjë.

Neni 18. Edhe ky nen është në rregull.

Neni 19, në këtë tabelë që keni propozuar për ndryshime të mundshme, nuk keni propozime konkrete.

Neni 20. Në rregull.

Neni 21. Në rregull.

Neni 22. Në rregull. Siç është në projekt.

Neni 23. Nuk keni ndonjë reflektim, do të ngelet ashtu siç është në projekt.

Neni 24 “Publikimi i vendimit përfundimtar dhe hyrja në fuqi”

Urdhëroni, zoti Majko!

**Pandeli Majko** – Këtu ka një sugjerim për afatet e parashikuara në shpalljen e vendimit të arsyetuar. Unë kam pasur edhe një diskutim me zotin Sadushi, por të jem i sinqertë edhe me ekspertë të tjerë, mendoj se duhet të qëndrojë afati i publikimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Domethënë, kjo historia e shpalljes së vendimeve dhe më pas arsyetimi mbetet nuk e di për çfarë, nuk besoj se kanë qenë shumë të rëndomta këto në veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese. Mendoj se përfundimisht duhet përcaktuar: “Gjykata Kushtetuese, pas marrjes së vendimit, brenda 30 ditëve duhet ta publikojë me arsyetimin përkatës”.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 25 ndryshon nenin 27 “Përmbajtja e kërkesës”.

**Pandeli Majko** – Jemi dakord që ky nen të ngelet kështu, pra kërkesa jonë është që të ketë short.

**Fatmir Xhafaj** – Mua nuk më duket ide joracionale, si mund të gërshetohet, sepse ka çështje shkojnë deri në treshe dhe ka çështje që shkojnë në seancë, nuk kanë të njëjtën volum pune dhe mund t’i bie një ngjeriu, që të ketë vetëm ato çështje, njëri të superngarkohet dhe tjetri...

**Sokol Sadushi** – Ne kemi dhënë opinionin që të mbetet siç është dispozita, sepse vendosja e shortit është një standard. Natyrisht, edhe ai që është sot në ligjin ekzistues, sipas të cilit i cakton kryetari, është një standard, por, duke qenë se ne kemi mbajtur një standard për sa i përket shortit, mendoj të qëndrojë. Shqetësimin që keni ju, zoti kryetar, e zgjidh sistemi retorik i shortit. Ai bën një ndarje, sepse evidentohen të gjitha çështjet që kalojnë në seancë dhe çështjet që janë në dorë të gjyqtarit. Pra, për ne nuk është shqetësim ky, sepse vetë sistemi duhet ndajë çështjet që janë në dhomë këshillimi nga çështjet që janë në seancë

gjyqësore. Për ata gjyqtarë që mund të jenë më shumë të ngarkuar me çështjen në dhomë këshillimi, do të bëhet një lloj rakordimi që të mos ngarkohen më.

**Fatmir Xhafaj** – A mund të vendoset kjo në ligj, duke mbajtur parasysh që të ketë një proporcion ndërmjet çështjeve?

**Sokol Sadushi** – Normalisht nuk vendoset në ligjin e Gjykatës Kushtetuese ngarkesa e gjyqtarëve, atë mund ta vendosë rregullorja e brendshme e gjykatës, e cila do të ketë rregulla procedurale.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë shtoni: “duke marrë parasysh sipas kritereve që do të caktojë rregullorja” dhe ata do ta bëjnë vetë.

**Sokol Sadushi** – Ngaqë ka një nen, i cili bën fjalë që ka një rregullore, e cila do të rregullojë të gjitha detajet.

**Fatmir Xhafaj** – Natyrisht, këtë e specifikojmë, u japim një lloj lirie atyre, me short.

**Sokol Sadushi** – Pranojmë parimin shortit.

**Fatmir Xhafaj** – Me short, pro ideja është çështja.

**Sokol Sadushi** – Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, por në vizionin tonë nuk është shqetësimi se ka një nen që do të parashikojë një rregullore që do të ketë. Kjo nuk e dëmton përmbajtjen.

**Pandeli Majko** – Jo, nuk është shqetësim. Jemi dakord me shortin.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë jemi dakord me ndryshimet e nenit 25, që ndryshon nenin 27.

Neni 26.

Dakord.

Neni 27.

Dakord.

Neni 28, nuk ka ndonjë ndryshim.

Neni 29, nuk ka ndonjë ndryshim.

Neni 30, nuk ka ndryshim dhe nuk është propozuar ndonjë sugjerim përmirësues për të.

Neni 31, mbetet siç është në projekt.

Neni 32, mbetet siç është në projekt.

Neni 33, mbetet siç është në projekt.

Neni 34, dakord.

Neni 35, dakord.

Neni 36, dakord.

Neni 37, dakord.

Neni 38, dakord.

Neni 39, dakord.

Neni 40, që ndryshon nenin 47 afatin.

**Pandeli Majko** – Mbetet 30 ditë, apo jo Sokol? Të lutem ma konfirmo, sepse mbetet në procesverbal. Thuaje me mikrofon.

**Sokol Sadushi**- Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – “Vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës”.

A jeni dakord?

Dakord.

Neni 42. Nuk ka propozime për ndryshim.

Neni 43 dakord.

Neni 44 dakord.

Neni 45 dakord.

Neni 46 dakord.

Neni 47 dakord.

Neni 48 dakord.

Neni 49 dakord.

Neni 50 dakord.

Neni 51 dakord.

Neni 52 dakord.

Neni 53 dakord.

Neni 54 dakord.

Neni 55, që shfuqizon nenin 65 aktual, dakord. dakord

Neni 56, i projektit që ndryshon nenin 66, “Subjektet kërkuese”.

**Pandeli Majko** - Te pika 3 është vendosur: “Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhjen e deputetëve me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit të pavarur për deputet” Është një riledhim, nëse mund ta quajmë kështu, i përgjithshëm i asaj që shkruhet edhe në Kushtetutë për sa i përket kësaj çështjeje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 57, mbetet siç është.

Neni 58, mbetet siç është.

Neni 59 te 67 “dh”.

**Pandeli Majko** – Sokol.

**Sokol Sadushi** – Këtu kishte nevojë vetëm për një saktësim të shkronja “b”, e nenit 67, “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e ligjit si të miratuar ose të gjuhëzuar”. Ndoshta duhet bërë një korrektim, sepse ligji si i miratuar është, mbete në fuqi, por thënë: “ i ligjit si dhe i shfuqizuar ose jo”. Ligji është, kjo duhet bërë për të shfuqizuar ligjin. Nuk miratohet me vendim ligji, ose shfuqizohet, ose mbetet i paprekur.

**Pandeli Majko**- Besoj se u kuptua pse kërkova që ta shpjegoni ju.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin që u tha.

Neni 60, që ndryshon titullin e nenit 68, dakord.

Neni 61, mbetet siç është. Nuk ka ndryshim.

Neni 62, që është neni 70, mbetet siç është.

Neni 63, mbetet ai që është në projekt.

Neni 64. Neni 71 “E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual”.

**Pandeli Majko**- Kemi një rregullim teknik.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 64 i zëvendëson nenin 71 “E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual”.

**Pandeli Majko** - Neni 64 i zëvendëson nenin 71 “E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual”.

**Sokol Sadushi** – Një saktësim, ky është gabim material për të bërë një saktësim në dispozitën përkatëse të Kushtetutës.

Neni 140 pika 4 është pika 3, kjo duhet saktësuar.

Unë e kam shënuar vetëm për ta pasur në vëmendje. Këtu është bërë vetëm korrigjimi.

**Fatmir Xhafaj** - Pika 2, sipas nenit 49 të këtij ligji dhe te pika 1 e nenit 71: “Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimin kundër Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 140 pika 4 dhe dhe 148/d të Kushtetutës”.

Dakord me ndryshimet e bëra.

Neni 65, sipas projektit, dakord.

Neni 66 i projektit që ndryshon nenin 72 pika 6, “brenda 5 ditëve”.

Dakord.



Neni 67 shtohet pika 3 “Formohet shumica e trupës së gjyqtarëve kërkesa konsiderohet e rrëzuar”.

**Pandeli Majko**- “Kërkesa konsiderohet e rrëzuar”, ka pak debat këtu.

Me Sokolin kemi ndarë disa opinione, sipas të cilave duket sikur mospjesëmarrja rëndon qytetarin, por gjithsesi, Sokoli thotë që duhet trajtuar në këtë mënyrë.

**Fatmir Xhafaj** – Parimi që ka Gjykata Kushtetuese Gjermane.

**Sokol Sadushi** – Ne menduam se të vendosim atë parim, do të shpëtojmë, por harruam që, nëse ne do të themi se kërkesa e individit që nuk do të arrijë të marrë 5 vota, pra, ka marrë 4 vota, quhet e pranuar, harrojmë që nga ana tjetër kemi një individ tjetër, i cili e ka fituar gjyqin në Gjykatën e Lartë. Përgjithësisht në gjykatat shqiptare vihen vendime gjyqësore individ ndaj individit, nëse një individ meqenëse gjykata nda 4 me 4, apo 4 me 3, pra jo 5 me 4 i quhet kërkesa e pranuar, harrojmë që kemi pjesën tjetër të individit që e ka fituar çështjen. Ne shkojmë me idenë se, le të mendojmë parimin e perzumimit të ligjshmërisë së aktit që kontestohet, le të arrijë individit me argumentin e tij 5 vota që të fitojë çështjen. Pak a shumë është ideja se, nëse nuk arrihen 84 vota në parlament, por arrihen 83 vota nuk ka ligj. Edhe në Gjykatën Kushtetuese ne nuk kemi zgjidhje tjetër. Me thënë të drejtën është pak delikate, por nuk kemi zgjidhje tjetër.

**Pandeli Majko**- Dakord, por paralelja kam përshtypjen nuk është se saktë, sepse në rastin e gjykatës kemi të bëjmë me interesa të caktuara të kufizuara, kurse për rastin e ligjit është një histori pak e ndryshme. Në një rast mund të diskutohet lobimi apo interesi politik, në rastin tjetër diskutohet treshja e interesit të individit.

**Sokol Sadushi** – Zoti Majko, më lejoni, nëse është e mundur, të marr një rast, unë kam fituar çështjen në Gjykatën e Lartë, pala kundërshtare e dërgon çështjen në Gjykatën Kushtetuese, dërgon vendimin që unë kam fituar. Në Gjykatën Kushtetuese, pala kundërshtare e fiton çështjen me 4 vota me këtë argument që kërkohet të japë kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Pra, nëse ka 4 vota ai e fiton çështjen, ndërkohë, unë që kam fituar në Gjykatën e Lartë, e humbas. Kështu që janë dy individë përballë njëri tjetër që dëmtohen.

**Fatmir Xhafaj** – Po ai që e ka humbur dhe shkon në Gjykatën Kushtetuese?

**Sokol Sadushi** – Ai që e ka humbur shkon në Gjykatën Kushtetuese, por shkon dhe fiton çështjen me 4 vota me propozimin që bën kryetari.

Nuk mund të ketë një fitore...

**Fatmir Xhafaj** – Gjermanët kanë një jetë të tërë që e kanë këtë standard dhe nuk e kanë konsideruar cenim.

**Sokol Sadushi** – Nuk kanë gjermanët këtë që kemi ne që të gjitha vendimet e Gjykatës së Lartë t'i çojnë në Gjykatën Kushtetuese. Ky është shqetësim që kemi ne.

**Pandeli Majko** – Unë mund të humbas vendimin në Gjykatë Kushtetuese, sepse 3 anëtarë të gjykatës janë në një konferencë studimore- kërkimore në Berlin.

**Sokol Sadushi**- Kjo situatë nuk mund të vijë, nëse gjyqtari është jashtë shtetit, ose kur gjyqtari është përkohësisht në gjendje jo të mirë shëndetësore. Kjo vjen kur ka pamundësi objektive që të jetë gjykata me 9 veta, ose në rast vdekjeje, ose në rast dorëheqjeje. Në rastet e tjera, nëse gjykatësi është jashtë shtetit, gjykata merr të gjitha masat që të bëhet e plotë. Do t'ju sjell në vëmendje, zotërinj deputetë, që Gjykata e Strasburgut ka mbajtur qëndrim lidhur me këtë dispozitë dhe e ka quajtur shkelje atë që gjykata shqiptare zbaton sot që e quan kërkesën të refuzuar.

**Pandeli Majko** - Sokol, përpara teje tërhiqem. Në rregull.

**Sokol Sadushi** – Ne tani nuk gjejmë zgjidhje tjetër.

**Pandeli Majko** - Një rezervë e kam unë, por dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Ju dhe zoti Rajner nuk futët gjyqtarët zëvendësues, kur jua propozuam ne. Ju ekspertët ishit kokëfortë në bindjet tuaja. Po të kishit gjyqtarin zëvendësues, nuk do të kishit këtë problem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Për rregullimin duhet bërë ndryshim në Kushtetutë. Nuk bëjmë dot ndryshim në Kushtetutë.

**Pandeli Majko** – Do t'i bëjmë zotit Rajner një bust dhe t'i themi juristëve të rinj sa herë të ankohen, t'i bërtasin këtij busti.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 67?

**Person** – Në gjykatat që janë me 9 gjyqtarë nuk ndodh ky problem, siç ndodh në Shqipëri.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 68?

Dakord.

Neni 69 mbetet siç është.

Neni 70 mbetet siç është.

Neni 71 mbetet siç është.

Neni 72 mbetet siç është.

Neni 73 mbetet siç është.

Neni 74 mbetet siç është.

Neni 75 mbetet siç është

Neni 76 mbetet siç është

Neni 77 mbetet siç është

Neni 78. Zbatimi i ligjit të ri. Ndryshimi i nenit 86.

**Pandeli Majko** – Është një ndryshim, i cili ka të bëjë me pikën 2 “këshilltarët ligjor që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 14/a të këtij ligji, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e tij, transferohen në një detyrë tjetër në administratën e gjykatës kushtetuese, ose si nëpunës civil gjyqësor brenda gjykatave ose prokurorisë sipas kriterëve të parashikuara për këtë qëllim”.

Në pikën 3 pas fjalës “ në nenet 50” shtohet “ pika 4” dhe pastaj vazhdon 71, 71/a, 71/b e kështu me radhë.

**Fatmir Xhafaj** – Ka një propozim për çështjet e afatit për ankimimin individual.

**Sokol Sadushi** – Është një sugjerim i drejtë që bën kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Ne projektligjin e kemi hartuar që në muajin korrik duke menduar që gjërat do të ecnin më shpejt dhe kemi parashikuar 1 janarin 2017. Atë vlerësojeni ju, por ndoshta ka nevojë për një shtyrje të lehtë. Ndoshta 1 marsi, nuk e di. Vlerësojeni ju.

**Fatmir Xhafaj** – Mund ta lëmë 1 korrik të vitit që vjen.

**Sokol Sadushi** – Ndoshta është pak vonë sepse mund të ketë avantazhe individit nga ky ligj i ri dhe ne do t’i krijojmë një disavantazh, sepse ka edhe avantazhe që të hyjë në fuqi sa më shpejt.

**Pandeli Majko** – 1 mars. Jemi dakord?

**Fatmir Xhafaj** – Mund të na jepni një mendim?

**Arta Vorpsi** – 1 marsi është afat i arsyeshëm, për shkak se ngushtohen afatet dhe është mirë që të fillojnë afatet e reja.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Unë ju dëgjova me vëmendje, por do të desha që të gjitha ndryshimet që janë bërë në këtë ligj të reflektohen tani...

**Fatmir Xhafaj** – Një minutë! Nuk ka lidhje... Ka lidhje me ankesat.

Biem dakord me ndryshimet e bëra te 1-shi, 2-shi dhe 3-shi?

Dakord.

Neni 79. Hyrja në fuqi e ligjit 15 ditë pas Fletores Zyrtare.

Dakord.

Kush është dakord në tërësi me të gjitha ndryshimet që iu bënë projektit bazuar në sugjerimet që u sollën nga gjykata kushtetuese dhe ato që u panë të arsyeshme për harmonizimin me ligjet e tjera? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Falënderoj zotin Devil dhe ekipin e tij!

Falënderoj zotin Sadushi, zonjën Vorpsi, dhe përkthyesit!

Një falënderim i veçantë shkon edhe për relatorin projektligjit zotit Majko!

**Pandeli Majko** - I cili u ndihmua nga Sokoli dhe Arta, sepse po të mos kisha pasur ndihmën e tyre, vështirë se do të isha kaq kompetent sot.

**Fatmir Xhafaj** – Për mbledhjen e ardhshme do t'ju njoftojmë. Do të jetë për SPAK-un dhe ato që lidhen me projektligjet e tjera që kemi lënë nga mbledhja e kaluar.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*